



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

KRYESIA

Nr. prot. 202

Tiranë, 28.02.2020

V E N D I M

Nr. 20.02.28.02.2020

P Ë R

NGRITJEN E NJËSISË SË KËRKIM-STUDIMIT NË FUSHËN E BIOSHKENCËS,  
BIOTEKNOLOGJISË DHE GJENETIKËS

Mbështetur në nenet 19 të ligjit nr.59/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe 45 të Statutit të ASH, me propozimin e akad. Efigjeni Kongjika dhe prof.dr. Ilia Mikerezi, me pëlqimin e dhënë nga Seksioni i Shkencave Natyrore Teknike dhe Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë, Kryesia e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e datës 28 shkurt 2020,

V e n d o s i :

1. Të ngrëjë pranë ASH një njësi të kërkim-studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe të gjenetikës, me emrin "Bioteknologji dhe Gjenetikë".
2. Njësia të përbëhet nga prof.dr. Ilia Mikerezi, drejtues shkencor, akad. Efigjeni Kongjika bashkëdrejtuese shkencore, prof. dr, Genc Sulçebe, prof. dr. Ariola Bacu dhe prof. dr. Grigor Zoraqi.
3. Objekti i punës së njësisë është realizimi i angazhimeve të përcaktuara në platformat dhe programin e punës të paraqitur nga akad. Efigjeni Kongjika dhe prof. dr. Ilia Mikerezi (bashkëngjitur).
4. Veprimtaria e njësisë do të synojë koordimin e kërkimit shkencor në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës, evidentimin e gjendjes aktuale të kërkimit në Shqipëri e rajon në nivel shkencor, logjistik e kapacitete intelektuale, zhvillimi i konferencave kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë, aplikimi për tërheqje projektsh evropiane, vendosja e bashkëpunimit me qendra homologe të

1 | F a q e

K o n c e p t o i :

P u n o i :


Adresa: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë; tel.: 0(4)222 7476;  
www.akad.gov.al

kërkimit, riorganizimin e saj deri në konsolidimin si një qendër reale e kërkimit shkencor.

5. Koha e veprimtarisë është deri në 2 vjet.
6. Pranë njësisë do të ftohen si anëtarë bordi e konsulentë, bashkëpunëtorë shkencorë e kërkues, ndër më të njohurit në këto fusha, sipas propozimit të drejtuesve të njësisë.
7. ASH siguron mbështetjen logjistikë dhe mbulon shpenzimet financiare për vepritarinë e njësisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI**



**Konceptoi:**

**Punoi:**